

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NIK MALUTAJ” SHPK



NENI 1
EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë është “NIK MALUTAJ” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 2
SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Abdi Tiptani”, Pallati Torre Drini, Kati 7, Ap 42, Tiranë.
- 2.2 Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: www.nikmalutaj00001@gmail.com
- 2.3 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të çelë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimitë Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I AKTIVITETIT

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj :

- **Ndertim:** Punime germimi në toke. Nderime civile dhe industriale, Rikonstruksione, mirembajtje godina civile e industriale, veshje fasada :Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, Punime nentoksore, ura e vepra arti, Diga dhe tunele hidroteknike, Ujesjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

Nderime detare dhe punime thellimi në ujë. Mbrojtje lumore sistemime, bonifikime Impiante të E. elektrike. Nderime për N/stacionet, kabinat, linja e TN, të mesem dhe shpërndarjes. Punime të inxhinierisë mjedisit. Punime për prishjen e nderimeve Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese). Punime rifiniture druri, plastike, metalike dhe xhami Impiante të sinjalistikës ndriçuese dhe jo ndriçuese të trafikut rrugor. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore special. Shtresa dhe mbistruktura special. Punime mbi shina dhe traversa. Impiante teknologjike, termike, elektrike, kondicionimi, telefoni, radiotelefoni, TV.

Pastrimi i ujrave detar, liqenor dhe lumor. Impiante të ujit të pijshëm dhe pastrim i tij. Impiante të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike. Sistemet kundër zhurmës. Shpime gjeologjike, puse e shpime për ujë. Pasuri Nen/Mbi Tokësore: Studim, zbatim, projektim, konsulenc, sipërmarrje, ndertim, shfrytëzim miniera, shfrytëzim të burimeve natyrore të ujrave minerale dhe termale; nxjerrje, prodhim, përpunim dhe tregtim brenda dhe jashtë vendit të mineraleve. **Turizem:** Studim, projektim, konsulenc, sipërmarrje zbatuese, ambiente me karakter pushues, argetues, edukues, kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, për hoteleri, fshatra turistike, qendra turistike, facilitete e aksesore, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njësi shitje, agjenci turistike.

Transport: Studim, projektim, konsulenc, sipërmarrje zbatuese, transport të njerezve dhe mallrave, tranzit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Ngarkim dhe shkarkim anije, trena dhe mjete

Nikolin Malutaj

tjera tokesore dhe ajrore; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrin i ngarkesave dhe konteniereve. Transport kombetar dhe nderkombetar, agjenci transporti per mallra dhe udhetare per te trete dhe me qira. Transport karburante.

Mjedis: Studim, projektim, konsulence, sipermarrje per mjedisin. Perpunim i mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike. Trajtim ujra industriale, projektim, mbikqyrje dhe shfrytezim te lendes drusore, trajtim dhe mbrojtje te pyjeve, riaftesim e trajtim toka te kripura, acide, këneta etj. **Prodhim:** industriale, bujqësore, blegtorale, peshkim, produkte deti, bletari, akuapunturë, fidane. Prodhim, montim dhe tregtim paisje druri, mobilje, tavolina, karrige, orendi metal, druri, plastike, mobileri te buta, tekstile dhe paisje e mobileri spitalore, shkollore, zyra, guzhina, restorante etj. Përpunim, prodhim, tregtim paisje e objekte guri, mermeri, alabaster, hekuri, bakri d/alumini, plastike, pvc, alukobond. Makineri e pasije per persona me aftësi të kufizuar ose speciale. **Sherbime:** Konsulence, studim e projektim te çdo lloji. Shërbim turizem, hoteleri fast food, piceri, restoran Ambjente argetimi, shlodhjeje, salle kinemaje, apo lojra te tjera elektronike; Pastrim sipërfaqe urbane, grumbullim dhe transport mbetje urbane. Sherbim riparim automjete, karrotrec 24 ore. Sherbim roje civile, per ruajtjen e rendit, jetes, levizjen e vlerave pasurore etj.

Tregti: Tregtim, importeksport shumice/pakicë si elektrike, elektronike, hidraulike, materiale industriale, ushqimore, bujqësore, elektroshtepiake, ndertimi, plehra kimike, pjese kembimi, karburante, lende djegese, vajra, lubrifikante, lende te para ndertimi, makineri dhe paisje, lende drusore, linja industriale, gjeneratorë, trasformatorë pajisje e pjese te tyre. Shitblerje skrapë dhe vaji. Stacione shitje karburante, gazi dhe vajra lubrifikante;

Te tjera: Botime, shtypshkrime dhe tregtim te tyre. Çertifikim dhe trajnim profesional në fushën e ndertimit, turizmit, bujqësisë, shërbimeve, prodhimit, mjedisit, pasurive nën/mbi tokësore, tregtimit, menaxhimit dhe administrimit. Punime dhe shfrytezim në pyje, perpunim dhe tregtim te lendeve drusore te te gjitha llojeve. Lavazhe, pika servisi etj. Minimarkete, supermarket, qendra tregtare, kontrata, marreveshje, bashkim operatoresh me persona fizike e juridike, vendas apo te huaj, per veprimtari ndërtimore, prodhimi, shërbimi, tregti, turizmi, bujqësi, mjedis. Punime me lëndë plasëse për përdorim civil. Import gjeneratorësh me rreze X.

NENI 5 KAPITALI

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (Njeqind mijë) Lekë, i nënshkruar dhe i ndarë në një kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit, e zotëruar nga Ortaku i Vetëm
Z. Nikolin Malutaj.

NENI 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

NENI 7 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 7.1 Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, për sa kohë që kapitali i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:

- 
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve ushtrimore;
 - c) vendimet për investime;
 - d) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

- 7.2 Çdo vendim i Ortakut të Vetëm që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
- 7.3 Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- 7.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverballi përkatës.
- 7.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori/ët ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, email, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për çështjet përkatëse.
- 7.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur ndërmjet të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 7.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 7.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 8 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i zgjedhur nga Ortaku i Vetëm për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Administratori i Vetëm i Shoqërisë do të jetë **Nikolin Malutaj**, me afat *pesë vjeçar* nga data e këtij akti.
- 8.2 Administratori i Vetëm gëzontë drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë.

8.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.

8.4 Ortaku i Vetëm përveç shpërblimit të organit administrues të Shoqërisë.

NENI 9 KONTROLLI FINANCIAR

9.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me ligjin në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emërojë një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

NENI 10 VITI FINANCIAR

10.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të Shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbyllet në fund të këtij viti.

NENI 11 BILANCI VJETOR DHE DIVIDENDI

11.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Ortaku i Vetëm.

11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Ortaku i Vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

11.3 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Ortaku i Vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 12 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

12.1 Dispozitat e ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare do të zbatohen në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë.

NENI 13 LIGJI I ZBATUESHËM

13.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut e ligjin shqiptar. Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky akt.

NENI 14 TË NDRYSHME

14.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarëtë njëjtë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 05/12/2018.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

Znj. Nikolin Malutaj

Nikolin Malutaj



QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT

Statut i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar “NIK MALUTAJ” SHPK

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit : 05/12/2018

Emri dhe Themeluesit : NIKOLIN MALUTAJ

(1) Sot, më 05/12/2018 une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “NIK MALUTAJ” SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është :

- **NIKOLIN MALUTAJ**
- Rr" Abdi Tiptani", Pallati Torre Drini, Kati 7

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- **Ndertim:** Punime germimi ne toke. Ndertime civile dhe industrial, Rikonstruksione. mirembajtje godina civile e industriale, veshje fasada :Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, Punime nentoksore, ura e vepra arti, Diga dhe tunele hidroteknike, Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.

Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje. Mbrojtje lumore sistemime, bonifikime Impiante te E. elektrike. Ndertime per N/stacionet, kabinat, linja e TN, te mesem dhe shperndarjes. Punime te inxhinierise mjedisit. Punime per prishjen e ndertimeve Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavaxerit, Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle levizese). Punime rifiniture druri, plastike, metalike dhe xhami Impiante te sinjalistikes ndriçuese dhe jo ndriçuese te trafikut rrugor. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Parafabrikate beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore special. Shtresa dhe mbistruktura special. Punime mbi shina dhe traversa. Impiante teknologjike, termike, elektrike, kondicionimi, telefoni, radiotelefoni, TV.

Pastrimi i ujrave detar, liqenor dhe lumor. Impiante te ujit te pijshem dhe pastrim i tij. Impiante te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Punime topogjeodezike. Sistemet kundra zhurmes. Shpime gjeologjike, puse e shpime per uje. Pasuri Nen/Mbi Tokesore: Studim, zbatim, projektim, konsulenc, sipermarrje, ndertim, shfrytezim miniera, shfrytezim te burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerje, prodhim, perpunim dhe tregtim brenda dhe jashte vendit te mineraleve. **Turizem:** Studim, projektim, konsulence, sipermarrje zbatuese, ambjente me karakter pushues, argetues, edukues, kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, per hoteleri, fshatra turistike, qendra turistike, facilitete e aksesore, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi shitje, agjenci turistike.

Transport: Studim, projektim, konsulenc, sipermarrje zbatuese, transport te njerezve dhe mallrave, tranzit rrugor, hekurudhor, ajror, uhor, teleferik etj. Ngarkim dhe shkarkim anije, trena dhe mjete tjera tokesore dhe ajrore; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrim i ngarkesave dhe konteniereve. Transport kombetar dhe nderkombetar, agjenci transporti per mallra dhe udhetare per te trete dhe me qira. Transport karburante.

Mjedis: Studim, projektim, konsulence, sipermarrje per mjedisin. Perpunim i mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike. Trajtim ujra industriale, projektim, mbikqyrje dhe shfrytezim te lendes drusore, trajtim dhe mbrojtje te pyjeve, riaftesim e trajtim toka te kripura, acide, keneta etj. **Prodhim:** industriale, bujqesore, blegtorale, peshkim, produkte deti, bletari, akuapunture, fidane. Prodhim, montim dhe tregtim paisje druri, mobilje, tavolina, karrige, orendi metali, druri, plastike, mobileri te buta, tekstile dhe paisje e mobileri spitalore, shkollore, zyra, guzhina, restorante etj. Perpunim, prodhim, tregtim paisje e objekte guri, mermeri, alabaster, hekuri, bakri d/alumini, plastike, pvc, alukobond. Makineri e pasije per persona me aftesi te kufizuar ose speciale. **Sherbime:** Konsulenc, studim e projektim te cdo lloji. Sherbim turizem, hoteleri fast food, piceri, restoran Ambjente argetimi, shlodhjeje, salle kinemaje, apo lojra te tjera elektronike; Pastrim sipersfaqe urbane, grumbullim dhe transport mbetje urbane. Sherbim riparim automjete, karrotrec 24 ore. Sherbim roje civile, per ruajtjen e rendit, jetes, levizjen e vlerave pasurore etj.

Tregti: Tregtim, importeksport shumice/pakice si elektrike, elektronike, hidraulike, materiale industriale, ushqimore, bujqesore, elektroshtepiake, ndertimi, plehra kimike, pjese kembimi, karburante, lende djegese, vajra, lubrifikante, lende te para ndertimi, makineri dhe paisje, lende drusore, linja industriale, gjeneratorë, trasformatorë pajisje e pjese te tyre. Shitblerje skrapu dhe vaji. Stacione shitje karburante, gazi dhe vajra lubrifikante;

Te tjera: Botime, shtypshkrime dhe tregtim te tyre. Certifikim dhe trajnim profesional ne fushen e ndertimit, turizmit, bujqesisë, sherbimeve, prodhimit, mjedisit, pasurive nen/mbi tokesore, tregtimit, menaxhimit dhe administrimit. Punime dhe shfrytezim ne pyje, perpunim dhe tregtim te lendeve drusore te te gjitha llojeve. Lavazhe, pika servisi etj. Minimarkete, supermarkete, qendra tregtare, kontrata, marreveshje, bashkim operatoresh me persona fizike e juridike, vendas apo te huaj, per veprimtari ndertimore, prodhimi, sherbimi, tregti, turizmi, bujqesi, mjedis. Punime me lendë plasëse per perdorim civil. Import gjeneratoresh me rreze X.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë per nje afat kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 4: Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr" Abdi Tiptani", Pallati Torre Drini, Kati 7,
(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :
www.nikmalutaj00001@gmail.com

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë (Njëqind mijë) Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **NIKOLIN MALUTAJ** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 Përfshirimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, **është 5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

- **Nikolin Malutaj, atesia Ded, i dt105.12.1993, me banim në Lezhe, Rruga Vellezerit Haradinaj, pajisur me pasaporte me nr personal.J31205065M**

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K U

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"NIK MALUTAJ" SH.P.K.

NIKOLIN MALUTAJ

Emer mbiemer

Nikolin Malutaj

07.05.12.2018

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 4689 REP
NR. 1318/1 KOL

VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten **05.12.2018** para meje noteres publike Miranda Xhemalce, Anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne Krugen "Zhan D'Ark", prane Gjykates se Apelit Tirane, u paraqit personalisht:

Z. **NIKOLIN MALUTAJ, atesia Ded**, i dtl 05.12.1993, me banim ne Lezhe, Rruga Vellezerit Haradinaj, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, pajisur me pasaporte me nr personal. **J31205065M**, e cila me deklaroi se sa siper eshte **AKT Themelimi - STATUT** i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "**NIK MALUTAJ**" SH.P.K, e perpiluar jashte zyres se noterise dhe e nenshkruar prej saj ne prezence te noterese. Une noterja e vertetoi sipas ligjit.



NOTERE
MIRANDA XHEMALCE

NOTERE
MIRANDA XHEMALCE
TIRANE - ALBANIA